

# **Keqtrajtimi eshte i padrejte Ne te gjitha gjuhet e botes**

**Abuse is wrong in any language**

La violence est inacceptable peu importe la langue

ਪਰਵਾਰਿਕ ਬਦਸ਼ੂਕੀ ਕਿਸੇ ਵੀ ਥੋਲੀ ਵਿੱਚ ਅਪੁਵਾਣ ਹੈ

Hành hạ là trái phép trong bất kỳ ngôn ngữ nào.

الظلم ممقوت في جميع اللغات

Zlostavljanje je zločin—na svim jezicima!

虐待是有悖文明的惡行。

El abuso es condonable en cualquier idioma

ذیت و بدرفت ری به هیچ زبانی قابل توجیه نیست

Xadgudubku af kasta waa qalad

In tutte le lingue, la violenza è inaccettabile.

Η ΚΑΚΟΜΕΤΑΧΕΙΡΙΣΗ ΕΙΝΑΙ ΑΔΙΚΗ ΣΕ  
ΟΠΟΙΑΔΗΠΟΤΕ ΓΛΩΣΣΑ

O ABUSO É MAU EM QUALQUER LÍNGUA

Okrutne traktowanie innych brzmi wstremnie  
w każdym języku.

You may photocopy this booklet without permission of the Department of Justice, provided that the material is accurately reproduced and acknowledgement of the source work is included. Written permission of the Department is required for the use of the material for any other format.

Cette brochure peut être photocopier sans l'autorisation du ministère de la Justice, à condition que le document soit reproduit de façon exacte et que la source soit indiquée. Une autorisation écrite est nécessaire pour l'utilisation de ce document sous toute autre forme.

---



**Published by the authority of /  
Publié avec l'autorisation du**

Minister of Justice and Attorney General  
of Canada / Ministre de la Justice et  
procureur général du Canada  
Ottawa, (Ontario) K1A 0H8  
(613-957-2687)

1999

**ISBN 0-662-02440-0**  
Cat. No / N° de catalogue J2-131/1995 A16

(Albanian / Albanais)

## **Falenderojme**

Departamenti i drejtësisë dëshiron te falenderojë Edukimin Legal Publik dhe Shërbimin Informativ te New Brunswick që na dha mundësinë për të publikuar materialin tonë.

Departamenti i Drejtësisë gjithashtu dëshiron te falenderojë dhe njeh kontributin e PLEI Network; kolegët ne provinca dhe avokatët: Qytetarinë dhe emigracionin e Kanadasë: Departamentin e Trashgimisë Kanadeze; Shendetësine Kanadeze etj...

Ky libër u shkruajt duke u konsultuar edhe me anëtar te grupeve te ndryshme etniko-kulturale dhe komuniteteve te ndryshme ne te gjithë Kanadanë. Ne jemi mirënjoës per asistencën e te gjithë atyre që morën pjesë në këtë proces, dhe i falenderojmë ata për kontributin e dhënë.

## Rreth ketij libri

Ky libër bën fjalë për gratë emigrante të cilat përjetojnë abuzimin fizik apo sexual në familje. Në qoftë se ju njihni dikë, një person i cili keqtrajtohet ju lutemi jepini këtë libër. Pyeteni atë nëse ka nevojë për ndihmën tuaj, i thoni asaj se nuk është vetëm.

Si një grua emigrante ju mund të ndiheni e vëtmuar. Ju mund të keni vështirësi për të komunikuar me njerëzit. Në qoftë se me ju po abuzohet, ju mund të jeni e frikësuar për veten dhe fëmijët tuaj.

Ju ndoshta keni nevojë te njiheni më mirë me ligjet Kanadeze, me të drejtat tuaja në këtë vend, dhe me ndihmën që mund të merrni në qoftë se me ju po abuzohet.

## Cfare eshte abuzimi?

Me ju është abuzuar në qoftë se dikush ju lëndon apo ju trajton keq.

**Abuzimi mund të jetë fizik, emocional, fiziologjik apo financiar.**  
Ju mund të pësoni më shumë se një lloj abuzimi.

**Zakonisht abuzuesi është burri, ish-burri, i dashuri ish-i dashuri.**

**Ne disa raste nje pjesëtar i familjes suaj, njerëz të tjerë apo pjesëtar i familjes së bashkëshortit tuaj.**

**Abuzuesi mund të jetë femër por në shumicën e rasteve është mashkull. thërrasin policinë.**

## Në raste urgjente

Telefonojini policisë apo një mikut tuaj, në qoftë se është e mundur

Vraponi për të dalë jashtë n.q.s., mendoni se kështu mund të jetë më e sigurt dhe njerëzit e tjerë të mund t'ju shohin ju.

Bertisni sa më shumë në mënyrë qe t'ju dëgjojne fqinjët dhe kështu ata do të

## **Këto jane disa shembuj të dhunës fizike:**

- Rrahja
- Shpulla
- Grushtimi
- Djegiet
- Therja
- Pickimi
- Shtyrja
- Shqelmimet
- Goditja me armë

## **Këto konsiderohen krime në Kanada**

---

### **Keqtrajtimi seksual është:**

- Prekjet seksuale apo aktivitet seksuale pa dëshirën tuaj.

## **Këto konsiderohen krime në Kanada**

---

### **Me poshtë do të paraqesim disa shembuj të keqtrajtimit emocional dhe fiziologjik.**

- Kërcënimet ndaj juve, fëmijëve, të afërmve tuaj apo kafshëve tuaja.
- Thyerja e gjërave të tuaja.
- Përgjimi apo ndjekja juaj.

## **Këto konsiderohen krime në Kanada.**

---

### **Shembuj te abuzimit financiar.**

- Marrja e cekut tuaj.
- Mbajtja e parave tuaja duke penguar blerjen e ushqemeve apo marrjen e ndihmës mjeksore të nevojshme.

## **Këto konsiderohen krime në Kanada**

**Format e tjera të keqtrajtimit nuk janë krime por konsiderohen vetëm keqtrajtime. Disa shembuj:**

- Përcmimi i juaj
- Fyerja juaj
- Injorimi
- Të bërtiturit ndaj jush
- Sharjet me fjalë të ndyra
- T'ju caktohet se ku do të shkoni ,çfarë do të bëni dhe me kë do të shoqëroheni
- Refuzimi për t'ju lënë juve para në përdorim

---

## **Ju mund të gjeni përkrahje**

Ka njerëz të cilët mund t'ju ndihmojnë.

Telefonojini shoqatës multikulturale apo ndonjë grupi që merret me problemet e refugjatëve .Informohuni se si minden ata t'ju ndihmojnë.Pyetini ata se ku mund të drejtoheni tjetër për ndihmë.

Policia do t'ju mbrojë ju dhe fëmijët tuaj.

Gjithashtu ju mund t'ju jepen:

- Këshilla dhe ngushëllime
- Një vend të sigurt për të qendruar
- Ndihmë financiare
- Ndihmë juridike që ju jepet pa para

- Ndihma për t'u larguar – ju mund t'i drejtoheni organeve ligjore për të siguruar kujdestarinë e fëmijëve, ndihmën financiare, gjithashtu edhe shkurorëzimin.
- Një marrëveshje paqësore nga një gjyq kriminal
- Një vendim gjyqi civil apo familjar.

Gjithashtu ju mund të merrni ndihmë në qoftë se vendosni që të qëndroni.

---

## **Ku mund të merrni informacion më të hollësishëm?**

- Vendstrehimet e grave
- Polici
- Zyrën e prokurorit
- Spital
- Organizatën multikulturale sociale
- Qendrën e gruas
- YWCA
- Shërbimet avokatore
- Linjat e posacme telefonike
- Shoqatat publike ligjore të edukimit dhe informacionit
- Zyrën për ndihmë ligjore
- Tek mesuesja e Anglishtes
- Doktori apo infermieret (motrat)
- Punonjësi social


## Ju nukjeni vetëm

Keqtrajtime ndodhin në të gjitha tipet e familjeve. U ndodh Kanadezeve dhe Emigrantëve. Ju ndodh grave që nuk kanë fëmijë, atyre të pasura, të varfëra, nënpunëse, shtëpiakeve, të rejave, të moshuarave. Ju ndodh grave të origjinave të ndryshme, të besimeve të ndryshme, të racave të ndryshme, kulturave dhe grupeve etnike të ndryshme. Keqtrajtimi mund të ndodhë në cdo moment të jetës.

## Nuk është faji juaj

Të diskutosh rreth abuzimit është shumë vështirë. Disa gra janë të turpëruara apo të frikësuara se familja apo shoqëria nuk do ti besojë. Por duhet të kujtoni gjithnjë se asnjë veprim i juaj nuk i jep të drejtën askujt për t'ju keqtrajtuar. Abuzimi nuk ka arsyetim. Asnjëherë nuk është faji i juaj.

Shumë gra kanë parë që abuzimi ka një cikël. Tensioni i krijuar vazhdon derisa keqtrajtuesi vepron me dhunë. Pas shpërthimit të dhunës ka një periudhe qetësie. Keqtrajtuesi mund të kërkojë falje dhe të premtojë se nuk do ta përsërisë më. Megjithatë me kalimin e kohës mund të rritet tensioni dhe keqtrajtuesi mund të vaproje sërisht dhunshem. Pra cikli i abuzimit do të vazhdojë.



---

## Fëmijët tuaj kanë nevojë të mbrohen

Djemtë të cilët janë rritur në një familje abuzive janë të predispozuar (më lehtë) që edhe ata të abuzojnë ndaj gruas së tyre apo edhe ndaj prindërve të tyre kur ata arrijnë një moshë të caktuar. Kurse përsa i përket vajzave janë të predispozuara (më lehtë) që të pranojnë të abuzohet me to duke menduar se jeta është e atillë. Fëmijët të cilët rriten me dhunë në familje mendojnë se dhuna është normale.

Në softë se keqtrajtuesi po keqtrajton dhe fëmijët tuaj, ju duhet të kërkonit patjetër ndihmë për ta. Keqtrajtimi ndaj fëmijëve dënöhët me ligj. Ju mund të shkoni të kërkonit ndihmë pranë qendrës së asistencës së fëmijëve, agjensive familjare, pranë organizatave këshilluese për këshillë, ndihmë apo këshillim.

Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtuesi.

---

## Është më mirë të rrimë apo të largohemi ?

Ju duhet të mendoni më parë për sigurinë tuaj dhe atë të fëmijëve tuaj. Ju mund të friksoheni dhe të mendoni që familja apo shoqëria nuk do tju përkrahin për këtë veprim. Kjo gjë mund të ndodhë. Megjithatë mos kjo s'do të thotë që është më mirë për ju dhe fëmijët tuaj që të jetoni nën keqtrajtimin e dikujt për hir të këtij opinioni.

Ju mund të vendosni të largoheni vetëm për një kohë të shkurtër. Ose ju mund të vendosni të largoheni për gjithnjë dhe ti jepni

fund martesës apo maredhënies suaj.

Drejtojini këto pyetje vetes:

- Sa e rrezikshme është të qëndroni?
- A ka ndonjë armë në shtëpi?
- A ka përdorur ndonjëherë keqtrajtuesi armë, si për shembull, thikë apo shkop për t'ju rrahur?
- A merr keqtrajtuesi juaj drogë apo alkol me shumicë?

---

## Çfarë mund të ndodhi në qoftë se ju vendosni të rrini?

Ju mund të mendoni që është më mirë për ju që të qëndroni.

Në qoftë se ju jeni lënduar merrni menjëherë trajtim mjeksor. Nuk keni pse të tregoni se kush ju ka shkaktuar plagët. Por është më mirë për ju, në mënyrë që plagët t'ju mjekohen ashtu sic duhet, që ti tregoni mjekut shkakun e vërtetë të krijimit të plagëve.

Mbajtja e shënimave ose ditarit rreth plagëve të krijuara si dhe të kohës kur ju jeni keqtrajtuar mund t'ju ndihmojë më vonë në qoftë se ju vendosni të largoheni. Është mirë që të keni një plan në qoftë se ju vendosni të largoheni me shpejtësi.

Faqet e para të librit telefonik kanë numrat e policisë dhe të të gjitha emergjencave të nevojshme. Është me rëndësi që ju të dini numrin e policisë për rastet urgjente.

Mblidhni informacione si për shembull adresë, numra telefoni të njerëzve të ndryshëm tek të cilët ju mendoni se mund të gjeni mbështetje. Në qoftë se ju keni mundësi, kursemi disa para.

Mundohuni të merreni me gjëra që ju bëjnë të ndiheni mirë. Ju mund të keni mundësinë që nëpërmjet këshilluesve të arrini të mësoni një profesion të ri. Kërkon familje apo shoqëri të cilat mund t'ju ndihmojnë.

Në qoftë se keqtrajtuesi dëshiron të ndryshojë mënyrën se si sillet, ai mund t'i drejtohet shoqërive të ndryshme dhe të këshillohet me një specialist. Me një ndihmë në afat kohor relativisht të gjatë shumë burra kanë arritur ta kuptojnë dhe të mos jenë më dhunues në drejtim të gruas, fëmijëve apo dhe dikujt tjetër. Por megjithatë është shumë e vështirë që burrat keqtrajtues të ndryshojnë mënyrën e sjelljes. Keqtrajtimi me kalimin e kohës rritet dhe asnjëherë mos mendoni se mund të zhduket vetevetiu.

---

## Kush do t'a fitojë kujdestarinë mbi fëmijët?

Në qoftë se ju do të largoheni nga një ambient abuziv ju keni të drejtë të bëni kërkesë për të fituar kujdestarinë mbi fëmijët tuaj.

Në qoftë se mendoni se fëmijët do të përjetojnë momente abuzive kur ju të largoheni merrini edhe ata me vete. Bëni kërkesë menjëherë në mënyrë që të fitoni vendimin e gjykatës për kujdestarinë mbi fëmijët tuaj. Një avokat do t'ju ndihmonte shumë në këtë moment. Avokati mund t'ju

ndihmojë gjithashtu që ju të fitoni me anë të vendimit të gjykatës ndihmën financiare për të siguruar jetesën. Kjo gjykatë do të vendosi në favor të fëmijëve, pra do të vendosi për ndihmën financiare të nevojshme nga ana e babait të fëmijëve për t'ju siguruar jetesën dhe do të gjejë zgjidhjen më të përshtatshme për ta.

Në qoftë se ju do të fitoni të drejtën e kujdestarisë së fëmijëve, I ati edhe mund të ketë të drejtë të paktën t'i vizitojë ata. Ju mund të kërkonit që dikush tjetër të ndodhet aty në momentin kur babai të vij t'i merr fëmijët apo kur t'i sjell ata. Në qoftë se ju jeni të preokupuar për sigurinë e fëmijëve tuaj, avokati mund të kérkojë që dikush të mbikqyri vizitat e babait me fëmijët.

Në qoftë se mendoni se babai I fëmijëve do të mundohet t'i largojë ata nga shteti ku jetoni, duhet të lajmëroni menjëherë avokatin. Në qoftë se do ta denonconi një problem të tillë atëherë gjykata mund të kérkojë që pasaportat e fëmijëve të mbahen nga kjo e fundit.

Në qoftë se jeni qytetare Kanadeze, atëherë duhet t'i telefononi Zyrës së pasapotave në numrin 1-800-567-6868 ose (613)994-3560. Kérkojni atyre të fusin emrat e fëmijëve tuaj në listën e posacme në mënyrë që në qoftë se babai mundohet të largohet dhe kérkon të sigurojë pasaporta për fëmijët ju do të njoftoheni menjëherë. Në qoftë se ju keni nënshtetësi tjetër atëherë kontaktoni menjëherë me ambasadën e vendit tuaj duke ju kérkuar atyre të mos japin pasaporta për fëmijët tuaj.

Në qoftë se ju keni një vendim të gjykatës për kujdestarinë e fëmijëve tuaj do të ishte më

mirë që një kopje te saj ta mban me vete për cdo rast. Gjithashtu ju mund t'i jepni një kopje shkollës së fëmijëve tuaj.

---

## Në qoftë se ju do të përjetoni një situatë keqtrajtimi a është e mundur që t'ju kthejnë në vendin tuaj?

Në qoftë se ju jeni një Nënshtetase Kanadeze apo rezidente permanente nuk mund t'ju kthejnë në vendin tuaj në qoftë se ju do të përjetoni një situatë keqtrajtimi.

Në qoftë se ju nuk e dini në jeni apo jo një Nënshtetas Kanadez atëherë telefonojini zyrës më të afërt që merret me këtë problem. Kérkonи numrin e kësaj zyre në faqet e kaltëra të numeratorit telefonik nën emërtimin "Citizenship and Immigration."

Në qoftë se ju jeni refugjat atëherë mund të aplikoni për të fituar rezidencën permanente. Të qenurit të martuar apo beqar nuk ka asnjë efekt në statusin tuaj.

Në qoftë se ju jeni në varësi të një refugjati i cili është në procesin e shqyrtimit të kërkesës për rezidence permanente për të dy ju, atëherë ai mund t'a anullojë aplikimin tuaj. Në këtë rast ju mund të aplikoni vet si refugjat. Ju mund të ndiqni procedurat e zakonshme ose të aplikoni për rezidencë nën aktin humanitar apo mëshirues. Do t'ju duhet të provoni apo të mbroni dëshirën tuaj për të qëndruar në Kanada. Duhet patjetër të dëgjoni një opinion ligjor. Telefonojini Qendrës së Emigracionit Lokal për t'u informuar sa më saktë. Këtë numër mund t'a gjeni në faqet e kaltëra (blu) të numeratorit

telefonik nën emertimin "Nënshtetësia dhe Emigracioni".

---

## Në qoftë se sponsori juaj vendos të mos ju sponsorizojë më, a do t'ju kthejnë në vendin tuaj?

Si një emigrant i sponsorizuar ju nuk do t'ju kthejnë në vendin tuaj vetëm përfaktin se sponsori juaj nuk do t'ju sponsorizojë më.

---

## Çfare ndihme mund të marre?

### Policia

Ju mund t'i telefononi policise në qoftë se keqtrajtuesi ju sulmon, ju kërcënon etj... apo thjesht shprehet se do të kryej një veprim të tillë. Policia do të vijë. Shumë oficer policie janë trejnuar që të dinë se si të reagojnë ndaj marrëdhënieve keqtrajtuese në familje apo gjetkë. Ata mund t'ju çojnë në spital në qoftë se ju keni nevojë përt'u mjekuar apo përt'u vizituar nga një mjek. Ata do t'ju ndihmojnë që ju të largoheni e qetë.

---

### Vendstrehimi i grave

Ju mund të shkoni në një vendstrehim të grave në qoftë se nuk keni asnje vend tjetër ku mund të shkoni. Ky është një vend i sigurt ku ju dhe fëmijët tuaj mund të qëndroni përsë disa javë. Në varësi të gjendjes suaj financiare juve mund t'ju kërkohet që të paguani për një pjesë të qëndrimit.

Punëtorët dhe vullnetarët do t'ju qëndrojnë afér do t'ju këshillojnë dhe do t'ju informojnë. Ata do t'ju ndihmojnë që të siguron ndihmën e duhur ligjore, ndihmën

financiare, gjithashtu do t'ju ndihmojnë të siguroni një banesë të re për të jetuar në qoftë se kjo është dëshira juaj. Aty gjithashtu do të gjeni ushqim veshje pampersa për fëmijën në qoftë se ju kur jeni larguar nuk keni pasur kohë apo mundësi për të paketuar.

Këto vendstrehime drejtohen nga komunitete të ndryshme. Numrat e tyre gjenden në librin telefonik. Këto numra mund të jenë të paraqitur në faqet e para të listes emergjencave. Ata nuk do t'i thonë keqtrajtuesit se ku gjindeni ju. Ju gjithashtu mund t'i telefononi këtyre vendstrehimeve thjesht dhe për t'u këshilluar. Ju nuk keni nevojë të tregoni se si quheni.

---

### Ndihma financiare

Në qoftë se ju nuk keni punë ju mund të keni nevojë për të marrë ndihmë apo asistencë financiare. Në qoftë se jeni rezident permanent apo nënshtetas, ju keni të drejtë për të bërë një kérkesë për një ndihmë të tillë. Njerëz të tjerë mund të bëjnë kérkesë gjithashtu. Varet se ku jetoni.

Provinca dhe territore të ndryshme kanë rregulla të ndryshme në lidhje me aplikimin për asistencë financiare. Telefonojini një zyre të zonës ku jetoni për të marrë një informacion më të saktë. Në qoftë se ju jeni një emigrant që sponsorizoheni dhe sponsori është burimi juaj i vetëm finanziar, ju sërisht mund të bëni kérkesë për të fituar një ndihmë sociale nga qeveria. Në per gjithësi emigrantët e sponsorizuar mund të bëjnë kérkesë për asistencë financiare.

Kur ju shkoni në gjyq për të fituar kujdestarinë e fëmijëve tuaj ju mund t'i kérkonit gjyqit që të gjitha shpenzimet e tij të

paguhen nga ana e babait, dhe gjithashtu ky i fundit të përgjigjet për anën financiare të tuajën dhe të fëmijëve.

---

## Çfarë ndodh në qoftë se....?

### Çfarë ndodh në qoftë se ju do të lajmeroni policinë?

Në qoftë se policia ka fakte për keqtrajtimin tuaj, atëherë ngrihet padi kundër keqtrajtuesit. Ju duhet t'i tregoni policisë rrëth keqtrajtimit që keni përjetuar. Policia mund ta arrestojë keqtrajtuesin, në qoftë se ata mendojnë se ka fakte të mjaftueshme për këtë problem.

Në qoftë se keqtrajtuesi është arrestuar , ai mund të qëndrojë në burg vetëm për disa orë derisa të paraqitet në seancën e dëgjimit. Pas kësaj atij mund t'i lejohet që të largohet, ai mund të mbahet akoma në burg vetëm në qoftë se gjyqtari mendon se ka arsyet e fuqishme.

Në qofte së ju mendoni se rrezikohet siguria juaj atëherë lajmëroni policinë para se ai të largohet. Gjyqi mund të vendos kushte për lirimin e tij. P.sh gjyqi mund të vendosë që keqtrajtuesi nuk duhet as t'ju takojë dhe as t'ju telefonojë. Në qoftë se keqtrajtuesi nuk do t'i zbatojë këto urdhera atëherë ai mund të arrestohet sërisht nga policia.

Në qoftë se ju keni frikë se ai mund të përpinqet që t'ju takojë dhe t'ju dëmtojë sërisht atëherë ju duhet të gjeni një vend të sigurt për të ndenjur si p.sh në vendstrehimin e grave .

## **Çfare ndodh në qoftë se policia padit keqtrajtuesin?**

Në qoftë se keqtrajtuesi pranon fajësinë në lidhje me keqtrajtimin ndaj jush apo ndaj fëmijëve tuaj atëherë gjyqi do t'a dënojë atë me një periudhë prove, me burgim apo kombinim të këtyre të dyjave. Keqtrajtuesit mund t'i kërkohet të ndjeki një specialist këshillimi si kusht i periudhës së provës. Burgimet janë të rralla sidomos në qoftë se kjo ështe hera e parë në gjyq. Në qoftë se ju jeni e frikësuar tregojani një gjë të tillë hetuesit në mënyrë që të jetë e mundur që krahas periudhës së provës të vihen edhe kushte të tjera për lirimin e tij.

Në qoftë se keqtrajtuesi nuk e pranon fajësinë atëherë, ju mund të dilni dëshmitarë në gjyqin që do të zhvillohet për të. Mund të kalojnë muaj derisa të zhvillohet gjyqi. Në qoftë se gjyqi vërteton fajësin e keqtrajtuesit atëherë ai do të dënohet. Ju mund të pyesni hetuesin në qoftë se ka shërbime të tjera për njerëz me probleme si të tuajat të cilat mund t'ju qartësojnë procesin gjyqësor.

## **A do t'a kthejnë në vendin e tij keqtrajtuesin?**

Në qoftë se keqtrajtuesi është nënshtetas atëherë ai nuk mund të kthehet, në qoftë se keqtrajtuesi është refugjat apo rezident permanent atëherë ai mund të kthehet në qoftë se gjyqi vërteton fajësin e tij për krimin e ushtrimit të dhunës në familje apo për ndonjë krim tjetër. Procesi i kthimit mund të zgjasë një kohë relativisht të gjatë.

---

## **Abuzim nuk është vetëm rrahja**

- A ndodhë ndonjë herë që keqtrajtuesi ju bën fajtore ose ju thotë që ju nuk keni vlera?
- .....
- A ju ndalon abuzuesi që të keni shoqëri?
- .....
- A ju ndalon abuzuesi që të takoheni me familjarët?
- .....
- A ju ndalon abuzuesi që të largoheni nga shtëpia?
- .....
- A ju bën abuzuesi që të trembeni përpara asaj që thotë ai?

---

## **Në qoftë se ju keqtrajtojnë**

- Ju nuk jeni vetëm
- .....
- Nuk është faji juaj
- .....
- Ka ndihmë
- .....
- Mbronи veten dhe fëmijët tuaj

---

## **Çfarë duhet të merrni me vete kur të largoheni**

Në raste urgjente largohuni sa më shpejt që të jetë e mundur. Mos u mundoni që të mblidhni gjérat për t'i marrë me vete. Vetëm ikni. Por në qoftë se do të keni kohë mundohuni që të merrni sa më shumë nga gjérat e shkruara më poshtë .

- Dokumenta të rëndësishme si p.sh certifikatat e lindjes, pasaportat, Dokumentat e qytetarisë, dokumentat e emigracionit,dokumentat e kujdestarisë së fëmijëve,vendimin e gjykatës si p.sh.marëveshjen e pajtimit,kartën shëndetsore, kartën e sigurimit social, dhe kartën e tij të sigurimit social
- para, kartë krediti
- Librin e ceqeve, librin e bankës, librin e kursimeve
- Nr tuaj të telefonit, dhe librin e adresave
- Ilacet
- Celësat e shtëpisë
- Patentën e shoferit , celësat e makinës
- Lodrat më të dashura të fëmijëve
- Veshje të fëmijëve për disa ditë
- Bizhuteri të vlefshme

Në qoftë se po mendoni të largoheni ndoshta do t'ju duhet që të paketoni një pjesë të këtyre gjërave dhe t'i vendosni në një vend të sigurt, duke menduar se do të largoheni me nxitim .

# **Terma të përdorur në këtë material**

## **sulm**

Sulm do të konsiderohet një akt ushtrimi force apo një kërcënim për të ushtruar forcë ndaj një individi nga një tjetër pa dëshirën e tij.

## **seanca e dëgjimit**

Kjo është një procedure e veprimeve të gjykatës mbas arrestimit të një personi. Kjo seancë vendos nëse këtij personi do t'i jepet një liri e kushtëzuar apo do të mbahet në burg derisa të zhvillohet gjyqi i tij ndaj akuzave të ngritura.

## **shqetësimi i nivelit kriminal**

Në qoftë se ai është duke ju ndjekur apo ju ka kontaktuar, a po ju ka kërcënuar juve ose fëmijët tuaj, ai ka kryer një shkelje ligjore e cila quhet shqetësim i nivelit kriminal.

## **prokurori**

Ky është juristi që përfaqson qëverinë. Prokurori përfaqson çështjen në seancën gjyqsore kur është kryer një krim.

Në qoftë se ju keni fituar kujdestarinë e fëmijëve tuaj atëherë ju përgjigjeni ligjërisht për të gjitha vendimet rreth fëmijëve tuaj si p.sh. rritjen dhe shkollimin e tyre etj... Në qoftë se ju keni fituar kujdestarinë mbi fëmijët tuaj atëherë ata jetojnë me ju por gjithashtu mund të vizitojnë edhe babain e tyre.

## **ndihma juridike**

Ndihma juridike mund të merret nga një avokat apo nga zyra e ndihmës juridike. Ndihma juridike mund të jetë falas. Kontaktoni me zyrat e mëposhtme për t'u

informuar se ku mund të siguroni një ndihmë juridike dhe mundësishët ajo të jetë pa pagesë si shërbimi i avokatëve, zyra e ndihmës juridike, apo zyra e edukimit publik.

### **urdhër nga gjykata civile apo familjare**

Në qoftë se ju jeni të friksuar për sigurinë tuaj, dhe nuk dëshironi të kërkonit ndihmën e polisë, ju mund të merrni një urdhër një vendim nga gjykatat e mësipërme ku duhet të jetë e caktuar që keqtrajtuesi duhet të qëndrojë larg jush dhe familjes suaj. Ju duhet të kërkonit ndihmë ligjore për t'u informuar rrëth kësaj procedure.

### **marrëveshja e pajtimit**

Në qoftë se ju jeni të friksuar rrëth sigurisë suaj ju ndoshta mund të keni mundësinë që të siguroni një marrëveshje pajtimi. Ky është një vendim i gjykatës që përfshin një sërë kushtesh. P.sh keqtrajtuesit mund t'i thuhet se nuk i lejohet që të kontaktojë me ju, t'ju shkruaj juve apo t'ju telefonojë. Në qoftë se ai nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara këtë marrëveshje policia ka të drejtë që t'a arrestojë atë. Në qoftë se doni që të informoheni me saktë rrëth kësaj marreveshje duhet të kontaktoni një avokat.

### **koha e provës**

Ky është një vendim i gjykatës kriminale që mund të jepet si një pjesë e dënimit ndaj fajtorit. Një individi në kohën e provës i vendosen gjithnjë një sërë kushtesh përlirim i tij, një prej te cilave mund të jetë ndjekja e seancave këshilluese.

---

## **Për informacion më të hollësishëm telefonojini**

### **Alberta**

Këshillit të Albertës  
për vendstrehimin e grave  
(780) 456-7000

Qendres se burimeve juridike  
(780) 492-5735

Ndihma juridike  
(403) 297-2260(Calgary)  
(780) 427-7575(Edmonton)

Edukimit publik, juridik  
(403) 343-3712

---

### **British Columbia**

B.C./Shoqata e Yukon per shtepite tranzitore.  
(604) 669-6943

Shoqata e sherbimit juridik e B.C.  
(604) 660-4600

Edukimi ligjor  
Shoqata e B.C.  
(604) 660-9870

Shkolla e ligjeve te Popullit  
(604) 688-2565

---

### **Manitoba**

Komuniteti juridik (Manitoba)  
Manitobas  
(204) 943-2382

Shoqata per vendstrehimin e grave  
(204) 785-8065

Ndihma juridike ne Manitoba  
(204) 985-8550

---

## **New Brunswick**

Departamenti i drejtësise,  
programi i ndihmes juridike  
(506) 453-6577

Edukimi juridik dhe publik  
(506) 453-5369

Koalicioni i shtepive tranzitore  
(506) 648-0481

---

## **Newfoundland**

Komisioni i ndihmes juridike  
(vetem ne Newfoundland)  
1-800-563-9911

Shoqata e informacionit te ndihmes juridike  
(709) 722-2643

Shoqata kunder dhunes ne familje  
(709) 739-6759

---

## **Northwest Territories**

N.W.T. Shoqata parandalimit te dhunes  
ne familje  
(867) 979-4500

Bordi i sherbimit juridik ne N.W.T.  
(867) 873-7450

---

## **Nova Scotia**

Komisioni i ndihemes juridike  
ne Nova Scotia  
(902) 420-6565

Shoqata e shtepive tranzitore  
(902) 429-7287

Shoqata publike per edukim juridik  
e Nova Scotia-s  
(902) 454-2198

---

## **Nunavut**

Programi i ndihmes juridike  
(867) 979-5377

---

## **Ontario**

Komuniteti i edukimit juridik  
(416) 408- 4420

Plani i ndihmes juridike  
(416) 947-3330  
(Sherbimi i referimit per avokat)

Shoqata e shtepive tranzitore  
(416) 977-6619

---

## **Prince Edward Island**

Komuniteti i informimit juridik  
(902) 892-0853

Shoqeria e shtepive tranzitore  
(902) 894-3354

Departamenti i marredhenieve provinciale  
Dhe qendra e avokature  
(902) 368-6043

---

## **Saskatchewan**

Shoqata e shtepive tranzitore  
(306) 652-6175

Komisioni i ndihmes juridike  
1-800-667-3764

Shoqata per edukim juridik  
(306) 653-1868

---

## **Quebec**

Federata per grate e dhunuara  
dhe e grave ne veshtiresi  
(514) 674-0324

Shoqeria e shtepive tranzitore per  
grate qe perjetojne dhunen  
konjugale  
(514) 279-2007

---

## **Yukon**

B.C/ Shoqata e shtepive tranzitore  
(604) 669-6943

Shoqata publike per edukim juridik  
(867) 667-4305

Shoqata per sherbim legal i Yukon-it  
(867) 667-5210

---

## **Qendra Kombëtare e Sistemimit të Dhunës në Familje**

Shendetesia Kanada  
Ottawa, Ontario  
Numer falas 1-800-267-1291  
Numer falas 1-800-561-5643